




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo  
Viti/na



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja d, neni 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 28.02.2022, merr këtë:

## V E N D I M

**Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së parë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë, të datës 31.01.2022**

### Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për procesverbalin e mbledhjes së parë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë, të datës 31.01.2022.

### Neni 2

Pjesë e këtij vendimi është procesverbali i datës 31.01.2022.

### Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË  
K R Y E S U E S I

Bekim Azizi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË PARË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 31.01.2022 (e Hëne) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit z.Bekim Azizi, Kryetari z.Sokol Haliti, nënkryetari z.Hasan Aliu si dhe këshilltarët e Kuvendit: Ramadan Deliu, Basri Sylejmani, Sokol Hyseni, Ekrem Ymeri, Arbnore Hajredini, Valentina Mehmeti, Ilir Zuka, Zejnepe Osmani, Ali Bajrami, Taibe Ibrahim, Jakup Demiri, Liridona Bislimi, Sejdi Emini, Nexhat Halili, Majlinda Shabani, Remzi Salihu, Durim Sylejmani, Lindita Demelezi, Taulant Haxhiu, Musli Neziri, Veton Ramadani, Vilsona Maliqi-Salihu, Zyrafete Rama, Anisë Zejnullahu, ndersa mungoj Reshat Aziz dhe Sokol Shaqiri.

Pasi u konstatua se prezent janë 25 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e parë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Me lejoni që në fillim të ju dëshiroj punë të mbarë të gjithë anëtarëve të kuvendit, drejtorëve të cilët kanë marr pozitë për t’i udhëheq drejtorit e caktuara, ju uroj suksese, duke pas parasysh nga seancat e kaluara, Zyra Ligjore e MAPL-së na i ka konfirmu ligjshmërinë e vendimit për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit, ndërsa për Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete ka kërkuar që të plotësohet me emra ashtu siç kemi thanë nga seanca e kaluar. Me leje sot mungon, Reshat Aziz, i cili është në udhëtim jashtë vendit. Meqenëse jemi në seancën a parë dhe këshilltarët janë të ri, e kisha dhënë një përmbledhje të shkurt, që kuvendi mban seanca të rregullta, të jashtëzakonshme dhe seanca solemne. Nëse një anëtar i kuvendit mungon pa arsye në tri seanca radhazi, e hup mandatin sipas ligjit për qeverisje lokale. Shefat e grupeve parlamentare kanë të drejtë diskutimi 5 minuta bazë rregullore për punën e kuvendit. Diskutimet e anëtarëve të kuvendit zgjasin nga 3 minuta, replika zgjat 1 minutë, drejtorët e drejtorive pikat që i paraqesin për seancat e radhës le t’i përmbahen edhe planit të Kuvendit deri me datën 10 të muajit vijues, mund t’i paraqesin pikat te sekretaria për pikat e radhës që i kanë të parapame për kuvend. Kërkoj nga LDK-ja, që të naj konfirmon se: kush është shef i grupit parlamentar.

**z.Illir Zuka:** Përshëndetje! Në emër të LDK-së, shef të grupit e propozojmë, z.Ali Bajramin.

**z.Jakup Demiri:** Përshëndetje. Nga LVV-ja, shef i grupit është Jakup Demiri.

**z.Musli Neziri:** Përshëndetje! Nga PDK-ja, shef i grupit është Taulant Haxhiu.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi i kuvendit:** Ne si zakonisht i kemi pas pyetjet dhe përgjigjet jashtë rendit të ditës. Unë sot po propozoj, pasi që e kemi raportin e kryetarit te komunës, që sot te kursemi nga kjo pikë e rendit të ditës, për faktin që kemi se çka të bisedojmë ne kuadër të informatës së kryetarit, pasi që e kemi

praktiku edhe me parë këtë. A jeni që ta hekim këtë pikë? Me një votë kundër, të tjerat pro, pika e deklaramit jashtë rendit të ditës me piken e kryetarit shkoj së bashku. Atëherë ju falënderoj.

Për këtë seancë kemi parapa këtë rend dite:

## R e n d d i t e

1. a) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e datës 06.12.2021;  
b) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal e datës 28.12.2021.
2. Dhënia e betimit të anëtares të Kuvendit Komunal, znj. Taibe Ibahimi.
3. Informatë(raport) për punën e kryetarit të komunës për periudhën Janar-Dhjetor 2021
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2022.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacioni për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore ne Gjilan - Dega në Viti.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e çerdhes së fëmijëve në Viti.
8. a) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin e vendimit 01-110/05-976, të datës 28.12.2021, për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;  
b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin e vendimit 01-110/05-974, të datës 28.12.2021, për formimin e Komitetit për Komunitete.

A ka dikush rreth rendit të ditës? Pasi që nuk ka për diskutim: Kush është që të punojmë me këtë rend dite, me ngritje dore. Me votat e të gjithëve u miratu rendit i ditës.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. a) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e datës 06.12.2021;  
b) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal e datës 28.12.2021

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Hap debat rreth procesverbalit. A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

**z.Jakup Demiri:** Përshëndetje! Tek proces verbali i mbledhjes inauguruese, kemi një vërejtje, ku shkruan që, munguan asamblistët e LVV-së. Kërkoj që të përmirësohet e të behet që, e kane leshu mbledhjen.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka të tjera vërejtje, me këtë vërejtje e hedh në votim procesverbalin. Me votat e të gjithëve u miratua procesverbalit. Dhe procesverbalin e datës 28.12.2021: A keni vërejtje për këtë? Pasi që nuk ka, e hedh në votim për miratim. Nga të gjithë u miratu ky procesverbal.

Pika e dytë e rendit të ditës:

2. Dhënia e betimit të anëtares së Kuvendit Komunal, znj.Taibe Ibahimi.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi;** Bazuar në vendimit të datës 19.01.2022 të KQZ-së, znj.Taibe Ibrahimimi emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Viti, nga subjekti politik LDK-ja, duke e zëvendësuar anëtares e

kuvendit, znj. Majlinda Ostregllava. Kërkoj nga Taibe Ibrahimimi të ngritët në këmbë dhe në bazë të leximit të betimit, ta jep betimin dhe ta nënshkruaj: Unë Taibe Ibrahimimi, "betohem (ose deklaroj solemnisht), se do t'i kryej me nderë, besnikëri, pa anim e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Vitisë, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë". Urime e suksese!

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

### **3. Informatë (raport) për punën e kryetarit të komunës për periudhën Janar-Dhjetor 2021**

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës, në mungesë të prezencës së kryetarit e bënë prezantimin e kësaj pike:** Faleminderit kryesues! Më lejoni në fillim, pasi që është seanca e parë që ju drejtohem, të ju uroj të gjithë këshilltarëve punë të mbarë dhe shëndet. Gjithashtu i uroj edhe drejtorët për udhëheqjen e drejtorive përkatëse. Më lejoni që këtu para juve të filloj me paraqitjen e informatës së punës së kryetarit, t'i thamë disa fjalë sa për fillim, pasi që materialin e keni marr në kohë, konform dispozitave ligjore kryetari ka përgatit një informatë, të cilën ju e keni marr me kohë, keni pas rast edhe me e lexu dhe me e shiku punën, e cila është bë gjatë viti 2021. Ju e dini që jemi ballafaqu më dy parë zgjedhje, jemi ballafaqu me pandemi, e cila po na përcjellë edhe tani, e ku kemi mungesë edhe të drejtoreshës, e cila po na mungon sot për shkak të virusit. Kemi bë përpjekje maksimale t'i kryejmë punët edhe pse ishte një prej viteve më të vështira për realizimin e planit në tërësi. Unë më shumë nuk po ju marr kohë. Materialin e keni para vete, për pyetje e juaja jam në dispozicion.

**z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Ali Bajrami, shef i GP-së të LDK-së:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pasi që është seanca e parë, kisha shfrytëzua rastin që, në emër tim dhe në emër të grupit parlamentar të LDK-së, të gjithë të zgjedhurve, duke fillu nga kryetari, nënkryetari, kryesuesit e drejtorive, asamblistëve të ju dëshiroj suksese e shëndet dhe pozitivitet në këtë mandat katërvjeçar. Të punojmë në të mirë të qytetarëve, që të ju dalim gjithherë aty ku ata kanë nevojë. Sa i përket pyetjeve parlamentare, nuk kam pyetje, sepse sa i kemi të emëruar drejtorët, sa i përket informatës së kryetarit, e kemi një pasqyrë për punën njëvjeçare që është bë, në përputhje dhe në harmoni me ligjet që janë në fuqi, duke fillu nga raporti i kryetarit. Njësitë që janë brenda kësaj zyre kanë bë një punë të mirë, një punë që është për t'u pëlqyer, me angazhim dhe përkushtim. Nuk do të kisha hy me i përmend me emra, sepse e kemi materialin para veti.

**z.Jakup Demiri, shef i GP-së të LVV-së:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Meqenëse nuk i kemi pasqyrat financiare, nënkryetari e shpjegoj çështjen e tyre. Edhe pse momentalisht e kemi mungesë kryetarin, tek puna e transparencës e kam ngrit si shqetësim vazhdimisht në momentin kyq të kuvendit komunal ka qenë i pa mbuluar me çështjen e informimit të publikut, sidomos me votimin e buxhetit. Tek puna e informatës, kemi mungesë që nuk e dimë se çka ka ndodhë me Zyrën e Prokurimit me zyrtarin nuk ka as një të dhënë. Tek puna e inspektiveve, tek ndërtimet, çka ka ndodhë, nuk kemi asnjë raport për ndërtimet pa leje që janë në qytetin tonë në midis të qendrës, kemi objekte pa leje të ndërtimit.

**z.Taulan Haxhiu, shef i GP-së të PDK-së:** I nderuari kryesues i kuvendit, të nderuar të pranishëm! Ju dëshiroj punë të mbarë të gjithëve. Unë kam përpara informatën e kryetarit, nuk po dëshiroj të bëjë shumë pyetje, sepse i kemi drejtorët e ri, e kryetari nuk është prezent, po vetëm deshta të lidhem tek investimet kapitale për vitin 2021, rregullimi i fushave sportive 169 mije e 942 euro. Një sqarim që ta dinë qytetarët tonë: Në cilat fusha është bë ky investim? Dhe pyetje tjetër e kam për ndërtimin e shkollës fillore në Pozharan, 250 mije euro në proces të përfundimit në shkollën "Halili Alidema" në Pozharan. Besoj që me një angazhim në vitin 2022, që të përfundon sa më shpejtë kjo shkollë, të cilën e presin me padurim nxënësit e kësaj shkolle. I kemi edhe do ankesa tek mirëmbajtja e rrugëve, sidomos tani në Janar, ku rrugët nuk janë pastru, kemi ankesë



për menaxhimin e mbeturinave, ku qytetarët kanë bërë pagesa e nuk ju është kryer shërbimi, e unë propozoj që drejtori i shërbimeve publike, që ata në këtë muaj të lirohen nga pagesa.

**znj. Liridona Bislimi:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ju uroj një vit të mbarë ekzekutivit dhe këshilltarëve të ri. Sa i përket raportit të kryetarit, besoj që do të kishte qenë mirë që të kishte qenë prezent edhe kryetari dhe t'i bëjmë pyetje atij personalisht. Kjo informatë ka shumë mangësi dhe zbrasira. Tek Zyra për Barazi Gjimore është një informacion shumë i mangët, ku nuk i kemi pasur numrat e saktë. Dijet që në komunën tonë, tek Zyra për Barazi Gjimore, vazhdimisht që katër vitet e kalume kemi pas ngecje në raportin e barazisë gjimore për pos arsim edhe në shëndetësi kemi pas dikun një barazi, në raportin tjera kemi pas mangësi duke filluar edhe në drejtorit tjera, këtu në këtë informatë kisha dëshirë me qenë edhe një pjesë e arsimit dhe e shëndetësisë, nëse ka filluar të bëhet ndonjë testim në shkollë paraprakisht më herët, mirëpo edhe testimet që janë bërë tash në pjesën e fundit, besoj që na duhet një informacion më i saktë për të gjithë mësimdhënësit dhe të gjithë nxënësit që janë testuar. Gjithashtu ka tre familjar që janë ankuar se, me testimet që janë bërë në shkollë, ka pas nxënës që në shkollë është testu dhe ka dal pozitiv, pastaj ka shkuar në shëndetësi dhe ka dal me test negativ. Kjo ka ndodhë në Komunën e Vitisë dhe ka pasur ankesa prej prindërve, e besoj që edhe ju jeni në dijeni, e besoj që ka qenë dashur të jeni më të sinqertë me qytetarët, të jepni një shpjegim, pse ka ndodhë kjo, ku ka qenë problemi. Tek semaforat në Viti jemi të gjithë të pranishëm, se çka ka ndodhur me semaforat, se si është gjendja e tyre. Ne si LVV kemi pas ngritur si shqetësim dhe kemi pas bërë një aktivitet, ku ju si ekzekutiv jeni pas tallur me atë rrethin tonë, po siç shihet po del që ai rrethi ka qenë një ide me e kapshme dhe më e sigurt për qytetarët, pasi që me vendosjen e semaforeve kemi me dhjetëra aksidente të shumta. Këtë e di edhe kryesuesi, i cili ka qenë një kritik i madh ndaj kësaj problematike edhe një shqetësim tjetër që dua ta ngrit për banorët e fshatit Sllatinë, me konkretisht në rrugën e Dardanisë. Këta banor kërkojnë në vendosjen shenjave të policit të vdekur dhe shenja e komunikacionit, sepse fëmijët janë afër rrugës. Këtë kërkesë e kam ngrit vazhdimisht edhe në mandatin e kaluar, por nuk është marr parasysh.

**z. Musli Neziri:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Njëheri ju uroj marrjen e detyrës, përgjegjësisë. Fillimisht më lejoni të ju shpreh ngushëllime për vdekjen tragjike që ka ndodhë në fshatin Drobesh, ku kemi humb një nxënës dhe na ka prek të gjithëve kjo familjes Dinarica, ju shprehim ngushëllime. Meqenëse raportin e kryetarit e kemi përpara, materiali na ka ardh me kohë, unë kam disa vërejtje rreth këtij raporti, ku mendoj që do të jetë mirë, edhe kolegët të cilët të shprehin mendimin që i përket rreth raportit. Fillimisht tek investimet kapitale janë shifrat të mëdha të kësaj që ka ndodhë në punën e kryetarit, që unë për punën që është bërë nuk muj me ja mohu askujt. P.sh.: e kemi këtu asfaltimi i rrugëve rurale në realizim e sipër, në vendbanimet e komunës në vlerë 620 e 2812 euro, Rregullimi i kanalizimeve me vlera e që nuk janë precizu, kërkoj që të precizohen, të jenë më transparent për qytetarin. Te rregullimi i rrugëve me zhavar, 200 e 1000 euro, nuk është e precizume se ku janë bërë ato rrugë. Mendoj që duhet të precizohen. Tek investimet kapitale tek DKA-ja, aty është cek që është bërë rrethoja sportive në fshatin Ballancë, ndërsa aty rrethoj nuk është kryer, është bërë betonizimi i tri shkallëve të tribunave dhe është bërë pjesa e rrethojës para shkollës, e siç është në raport nuk është. Tek Drejtoria e Shëndetësisë janë cek ambulancet e mjekësisë familjare, aty është cek edhe ambulanta e Zhitisë ekziston e nuk është cek që ka funksionu. Kërkoj që të funksionalizohet gjatë këtij viti, për arsye se e dimë që jemi tu jetu me një virus famëkeq e që po merr jetë qytetarëve e gjithë banoret e asaj zonës, si: fshati Ballancë e Zhiti kanë pas nevoja për këtë. Tek Drejtoria e Bujqësisë është cek që kanë aplikuar për subvencione, po nuk janë cek që a kanë përkrah ata fermer për subvencione të ndryshme.

**znj. Majlinda Shabani:** I nderuari kryesues, përshëndetje të nderuar të pranishëm. Meqenëse është seanca e parë për këtë mandat, uroj që të na prin një punë sa më efektive e në shërbim të qytetarëve. Meqenëse jemi opozita e vetme në kuvend, uroj në bashkëpunimin e ndërsjellët që t'i primë interesave të qytetarëve para

interesave tona personale. Sa i përket raportit të kryetarit, po du mu fukusu tek Drejtoria për Shërbime Publike, me ç'rast gjatë gjithë periudhës së kohës së fushatës kemi bisedu dhe kemi pa që qytetarët edhe pas një qeverisje pothuajse një dekadë akoma ankohen për ujë të pijshëm, dhe probleme me kanalizime. Meqenëse në këtë raport siç është cekur, që ka gjithsej 85 intervenime në rregullimin e kanalizimit dhe ujësjellësit, zhbllokimet e kanalizimeve, ndërrim të gypave etj. shihim që për çdo vit puna po bëhet në mënyrë sipërfaqësore dhe qytetarët po ankohen akoma për këto problematika. I bëjë thirrje kryetarit të komunës, që në mënyrë primare dhe emergjente me u fukusu pikërisht në rregullimin e ujit të pijshëm dhe tek kanalizimet për qytetar, sepse është një fushë, ku qytetari ka kontakt direkt dhe nuk mundet me u fukusu në fushat e tjera, përderisa kemi probleme të nevojave bazike dhe esenciale. Sa i përket mirëmbajtjes së ndriçimit publik, në përgjithësi e shohim që në fshatra kemi akoma problem me ndriçim, konkretisht po du mu fukusu tek fshati Lubishtë, ku gjysma e fshatit është me ndriçim publik, ndërsa gjysma nuk ka ndriçim publik, mirëpo pothuajse në secilin fshat kemi probleme të ndriçimit publik. Sa i përket mbeturinave, një sugjerim apo kërkesë prej anës së komunës, e kish parapa që me u mundësu shtimi i kapaciteteve në kompaninë publiko-private "Eko-Higjena", në mënyrë që menagjimi i tyre të bëhet sa më i mirë e me i drejtë. E dimë që në periudhë ku zakonisht mërgimtarët janë në pushime, siç e kemi pas periudhën e Verës, kemi pas shumë ankesa, që mbeturinat kanë qenë në sasi të madhe të gjeneruar dhe si pasoj kemi pas problem. Sa i përket kësaj, edhe gjithashtu në raport ceket. Sa i përket mirëmbajtjes së parqeve, shesheve, sa i përket kësaj, ju bej thirrje dhe kërkesë, që të mirëmbahen parqet dhe sheshi i qytetit të Vitisë. Siç mundemi me e pa, sheshi dhe trotualet në përgjithësi akoma janë me borë dhe kështu kisha bë thirrje që te pastrohen. Kam pa qe raporti ka edhe mangësi të tjera, po meqenëse janë drejtorët, e rifokusohemi në raportet tjera.

**z.Remzi Salihu:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë do t'i bëj dy pyetje para se me hi tek raporti. Pyetja e parë është për kryetarin: Çka është bë me rrjedhje të ujërave të zeza në vendin e quajtur Stublla? Ky fenomen dijet se sa ka rrjedhje të ujërave të zeza. Pyetja e dytë për nënkryetarin, lidhur me konkursin publik për ndarjen e bursave të shpallur me 14.11.2019, pyetja, ka qenë ndarja e bursave: A ka qenë ligjore apo jo ligjore, ndërsa përgjigjen që kam pas marr për këtë pyetje ka qenë, plotësisht ka qenë ligjore. Edhe njëherë po du me e dëgju nga ti, që a ka qenë ligjore apo nuk ka qen ligjore, ajo ndarje e bursave. Tani tek raporti njëvjeçar tu thamë se po jetojmë më një kohë të pa kohë, ku nuk dijet se kush çka është kush çka meriton, me meritë e pa meritë dhe kush kënd sa më shume e shantazhon. Megjithatë treni ka filluar të bihet në binar edhe pse nga një lokomotivë tejet e ndryshkur dhe e stervjetruar, po si do që të jet, francezet thonë "selavia", duke analizuar këtë raport, pyesja veten, se a është e mundshme që, aq shumë punë brilante t'i kenë bë në letër, po që shume pak po shifen në vepër, apo më mirë të themi që, shumica atyre punëve edhe nëse janë bë, janë bë pa standarde dhe shkel e shko, duke provuar t'i sjelli disa dëshmi të dështimeve, e që nuk janë të pakta. Po filloj nga Zyra e Kryetarit, konkretisht Njësia për Burime Njerëzore, ku nder tjerash thuhet: Drejtoria e Arsimit për periudhën e shtatorit, me kërkesën e drejtorëve të shkollave ka rekrutuar këto profile. Nuk po i ceku po nuk tregon se a ka ndonjë rast ku nuk është kërkuar kriteri të jesh anëtar i LDK-së të jesh votues i LDK-së, të jesh i afërt i ndonjë pushtetari, apo të jesh thjesht nga Begunca, apo të jesh bijë apo nuse e Beguncës. Shkojmë tek Zyra e Prokurimit, dijet që kjo zyre punën dhe aktivitetet i zhvillon bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik, e bazuar në këtë, kjo zyre ka përgatitur këtë raport për kryetarin e komunës, duke përmbledhur të gjitha aktivitetet e prokurimit për vitin 2021 dhe duke numëruar aktivitete me radhë. E unë pyes: A është ky raport i kryetarit apo i Zyrës së Prokurimit, sepse aty thotë Zyra e Prokurimit ka përgatit, e kur e dimë qe kishte ndodh diçka e jashtëzakonshme në këtë zyre. Tash kur u përpilua raporti i kryetarit, nuk do te kalonte në heshtje pa e përmendur burgosjen e shefit të Zyrës së Prokurimit dhe pa treguar që nuk ka tjetër të licencuar, e që mundet ta kry atë punë, Drejtoria për Financa, Ekonomi. Projektet investime kapitale për vitin 2021, të financuar nga

Buxheti i Komunës së Vitisë, buxhetin e nivelit qendror, thotë: ndërtimi i ambulancës së fshatit Tërpezë, 20 mijë euro; ndërtimin e çerdhes së fëmijëve në Qifllak, 60 mijë euro. Këtu do ta bëja një pyetje, janë këto ndërtime që me ndërtim kuptojmë nga themeli apo janë riparime. Drejtoria për Inspektim, inspektori i ndërtim, gjatë kësaj periudhe raportuese janë inspektuar objektet të kategorisë së parë dhe të dytë, dhe për të gjithë ata që nuk kanë respektuar urdhëratë e inspektorit, janë marr masa ndëshkuese, si: gjoba mandatore, kallëzime penale, ama ne po shofim vetëm objekte pa leje të cilat shëmtoj edhe pamjen e vet qendrës së qytetit, madje për t'i adresuar dëshmitë thuhet se, mungesa e një inspektori të ndërtimit ka pasur ngecje dhe pengesa në legalizimin e objekteve sa i përket ndërtimeve pa leje. Pra, si është e mundshme të kesh kaq shumë punëtor të tjerë të punësuar, me kritere e pa kritere, e mos të gjesh buxhet për një inspektor të tillë.

**z.Illir Zuka:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë i kam dy kërkesa. Ajo e para është të intervenohet sa më shpejtë në çerdhen në fshatin Pozharan, ndërrimi i tapetit, për arsye që fëmijët që janë aty janë shumë, kanë ftoftë shumë dhe e kemi edhe një shqetësim tjetër. Para një kohe ka ndodh një aksident në qendër në Pozharan, ku është demtu muri mbrojtës i shtatores "Mejdi Korrani". Unë në atë kohë kam diskutu disa herë me drejtorin Adnanin, po procedurat gjyqësore deri sa të kryhen, po tani u bë një kohë që tani prej drejtorit të shërbimeve publike, z.Basri Aliu kërkoj me intervenu se ka mbet shumë keq, është bash në qendër. Edhe një kërkesë nga qytetaret e Pozharanit, e kame prapë për drejtorin e shërbimeve publike, të bëhet pastrimi i trotuareve. E dimë që kohen e fundit po dalin njerëzit e po ecin edhe në mbrëmje, dhe trotuaret janë të pakalueshme.

**z.Ali Bajrami:** Për mu është e papranueshme në këtë kuvend fjala rrebel, se nuk jemi asnjë ne këtu rrebela. Prandaj kërkoj të përdormi gjuhë parlamentare, sepse jemi të zgjedhur nga populli.

**z.Nexhat Halili:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Së pari i kam dy pyetje, megjithë premtimet me gjithë aktivitetet për ujin e pijshëm edhe ujin në fshatin Trestenik, ne dy Sadovinat, ne dy Sllatinat ka funksionu ujësjellësi deri para tre muajve, tani që tre muaj ujë nuk ka. Arsyen pse është ndërpre uji, këtë përgjigje e kërkoj nga kryetari dhe nga drejtori i shërbimeve publike. Dhe pyetja e dytë, lidhet me aktivitetin e prokurimit. Tash në web të komunës është bërë publikimi, furnizime me derivate të naftës për njësitë shpenzuese. Në web të komunës dy here është shpall i njëjti tender me datën 11.01 edhe 20.01 me procedura të njëjta. Pyes pse është inicuar kjo procedurë e prokurimit kur derivatet e naftës, kontrata është nga Agjencinë Qendrorë të Prokurimit, është valide deri në vitin 2023. Arsyen pse e ka ndërpre "HIB-i", që e ka furnizuar me naftë apo e ka ndërpre AQP-ja për Komunën e Vitisë. Tash tek raporti i kryetarit, unë shoh që Zyra e Prokurimit ka bërë, i ka paraqitur në raport të kryetarit këto aktivitete se qysh janë me procedura. E shoh një procedurë të përgjithshme, po nuk shoh që janë të specifikuar cilat kontrata, sa ka qenë ndarja buxhetore, sa ka qenë alokimi, sa ka qenë zotimi për aktivitet, sa janë nënshkrimi i kontratës, sa janë mjete të pashfrytëzuara për këtë kontratë, këto nuk i shoh. Një pikë që e shoh këtu, Zyra e Prokurimit merret me pagesa. Zyra e Prokurimit nuk merret me pagesa, Zyra e Prokurimit merret me përgatitjen e dokumentacioneve për dorëzim në Zyrën e Pagesave në thesar. Tash shoh dy aktivitete, procedura të prokurimit janë ankesë, cilat aktivitete janë këto nuk janë të specifikuar kerkun këto, se cilat aktivitete të prokurimit. Shoh dy projekte të nënshkruara, po nuk janë nënshkru nga zyrtari i prokurimit ose këtu ceket që, zotimi i mjeteve nuk është bërë prej Ministrisë së Infrastrukturës. Nëse nuk është bërë zotimi i mjeteve prej kësaj ministrie, pse e ke inicuar atë procedurë të prokurimit kur nuk i ka pas mjeteve ose alokimim. Duhet të përgatitet një deklaratë e nevojave, e cila të autorizon për fillimin e procedurave të prokurimit. Unë atë nuk po e shoh. Tek Drejtoria e Administratës, tek sektori i administrimit, tek derivatet e naftës, unë e shoh që derivatet e naftës janë litra, po nuk janë sa është pagesa e këtyre derivateve të naftës, sa kilometra kanë vepru këto automjete, sa shpenzojnë këto automjete në 100 kilometra. Tek Drejtoria e Shërbimeve Publike, mirëmbajtja verore dhe dimërore janë katastrofë. Nuk e shoh



këtë kompani a ka punu apo nuk ka punu hiq. Tek Drejtoria e Shërbimeve Publike, thuhet se 94% është realizu përçindja e buxhetit, mirëpo kur llogaris unë, nuk del 94 % , më del më pak se nuk e di a nuk dinë me e llogarit apo çka është problemi. Merreni, llogaritni edhe e shini. Këtë raport mund ta sheh gjithsekush, të paktën të jeni me vigjilent.

**z.Durim Sylejmani:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Sa i përket raporti të punës së kryetarit, e kam lexuar me kujdes këtë raport dhe do të ndalem në tri pika. E para ka të bëjë me Sektorin e Pylltarisë dhe zhvillim rural. Pyjet janë të prera gati të gjitha në Komunën e Vitisë. Druj për zjarr nuk kanë mbetur pothuajse fare, sepse në vite me masë të madhe janë kontrabanduar në qytete tjera, ndërsa në raportin e kryetarit më shumë krenari deklarohet se, për një vit ka konfisku 15.30 meter kub, madje kryetari i komunës vitin 2021 e ka shpallur vit të mbrojtjes së pyjeve. Ky është një absurditet i madh, ky është krim ndaj natyrës dhe krim financiar. E dyta, ka të bëjë me Sektorin e Administrimit. Në raport thuhet: shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve dhe gjeneratorëve për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës se Vitisë për periudhën raportuese janë 3788 euro. Shpenzuesit e kësaj shume janë: Administrata me 15 mijë e 953 euro, Shëndetësia me 13 mijë e 693 euro dhe Njësia e zjarrfikësve 5638 euro. Kur i mbledhim këto shifra, dalin 35 mijë e 284 euro e jo siç shkruan në raport 3788 euro. Dikush mundet të thotë, që është gabim teknik. Edhe po te jet gabim teknik, prapë nuk përputhen shifrat, sikur të mos të mjaftonte ky gabim teknik, prapë hasim në mos përputhje të shifrave në raport. Thuhet se shpenzimet për derivate të naftës për automjete gjenerator, nxemje qendrore, dhe autorizimet për të gjitha njësitë shpenzuese te Komunës se Vitisë janë 64 mijë e 836 litra, ndërsa kur i mbledh shifrat që ka shpenzuar Administrata, Shëndetësia dhe Njësia e Zjarrfikësve për derivate të naftës për automjete për nxehje qendrore e për gjenerator, del se ka shpenzuar 69 mijë e 697 litra, 4861 litër më shumë se shifra totale e deklaruar këtu ka dyshime të thella për keqpërdorime të derivateve. E treta ka të bëjë me mirëmbajtjen e ndriçimit publik dhe dekorimit të qytetit. Me 7 dhjetor 2020, Komuna e Vitisë ka lidhur një kontratë njëvjeçare me kompaninë "Atc-kom", në vlerë prej 56 mijë e 619 euro e 50 cent, ndërsa me 23 nëntor 2021 ka lidhur kontratë të re njëvjeçare me vlerë 80 mijë e 845 euro, përkundër faktit që kjo kompani nuk ka ofruar asgjë të re nga kontrata e mëhershme. Pse ju si komunë duhet me ja dhënë 24 mijë euro më shumë pa ofruar kompania asgjë më shumë, apo ndoshta këtu ka hise dikush? Për gjatë tetë viteve qeverisjen e Sokol Halitit e kanë përcjellë nepotizmi, kontratat mbi vepër, punësimet politike, tenderomani në masë të madhe e deri tek kulmi i kësaj qeverie, arrestimet e zyrtarëve komunal. Të dashur qytetar, këto muaj të fundit në Republikën e Kosovës po luftohet krimi si asnjëherë më parë që nga paslufta. Së fundit është arrestuar ish kryetari i Shtërpcës, Bratisllav Nikoliq, i dyshuar për marrje të ryshfetit në këmbim të dhënies së lejes ndërtimore. Dhënie ryshfeti dhe keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, ajo se çka e lidhë Komunën e Shtërpcës dhe Komunën e Vitisë është krimi, i cili ka ndodhur brenda këtyre dy komunave. Për Komunën e Shtërpcës duket që drejtësia vepro, e për kryetarin e Komunës së Vitisë, nëse ka ligj e drejtësi në këtë vend, e nëse prokuria ka ende gërshtë. ka me i ra me i pre tesha ngjyrë portokalli. Unë nuk e di kur ka me i dizajnu prokuroria këto tesha, e nuk e di kur gjykata ka me ti vesh, vetëm një gjë e di, që Sokol Haliti nuk e përfundon mandatin. Edhe krejt në fund, e kam një pyetje për kryesuesin. Ti Bekim Azizi, si kryetar i PDK-së në Viti, nga kjo foltore si opozitë e ke akuzu Sokol Halitin si shpëlarës së parasë në rastin e fabrikës së tekstilit, e cila është mbyll më vonë. A mendon që është ende shpëlarës apo nuk e ki thanë të vërtetën atëherë.

**z.Sokol Haliti, kryetar i komunës:** Këshilltar, ja ke nis shumë mbrapë. Po me vjen keq me ta kontestu edhe legjitimitetin, sepse nuk je as legjitim, sepse nuk je betu hiq, e nëse ka bë dikush krim ke bë ti, sepse nuk je betu. Respekt për të gjithë të pranishmit! Ju përshëndes të gjithëve! Sa i përket informatës që e keni para vete, ne e kemi kry një obligim ligjor, një standard që është informata për vitin e kaluar. Për disa pyetje që u ngritën në mbledhjen e radhës i kemi pasqyrat financiare, të cilat i konkretizojnë pyetjet e parashtruara nga



ju. Legjitimitetit tim e kanë verifiku qytetarët. Drejtësia do të vlen edhe për ata që e kanë shkatrru malin, ligji vlen për të gjithë. Tek uji i pijes, te nafta, këto detajohen tek pasqyrat financiare. E kemi raportin e auditorit të pakualifikuar, i kemi mbi 90 përqind investimet kapitale, i kemi 103 përqind tatimin në pronë. Për tema tjera mund t'i thirrjmë zyrtarët me bisedu më specifikisht për tema. Të hyrat vetanake i kemi rritë. Te rregullariteti ligjor nuk kemi vërejtje, e për fat të mirë, ti këshilltar nuk mi pren mu teshat. Unë në vitin '89 kam qenë në Burg të Dubravës, e ka gjeneratë këtu që i dinë peshën e atëherit. Unë këtë që e thash ti këshilltar, nuk ja dëshiroj askujt. Ju drejtuat me pyetje edhe kryesuesit, se çka kemi fol ne në fushatë zgjedhore. Nuk ka hiq rëndësi ajo, ne tash jemi bashkë për ta zhvilluar Vitinë, për ta qu përpara Vitinë dhe ju lutem me ju bashkëngjit edhe ju në progres, Vitisë. Për çerdhe e për ambulant, nuk është në riparim ambulanta në Terpezë, është ndërtesë e re, kemi bashkëparticipu me donator. Çerdhja në Qifllak është rivitalizim. E kemi shfrytëzuar objektin që ka qenë. Bursat janë transparente, kanë mu dhanë edhe këtë vit. Është nda fondi. Ujërat e zeza, këtë çështje e kemi ngrit shumë herë me Komunën e Ferizajt. Po ne mundemi prapë të organizojmë një takim së bashku të gjithë me institucionet e Ferizajt.

**z.Bekim Azizi Kryesus i kuvendit:** Ju lutem, ta respektojmë rregulloren, mos te flasim fjalorë që nuk i takon një këshilltarit komunal. Do të diskutojmë të gjithë, mirëpo të rumi nga fjalori e ta respektojmë njeri tjetrin, ta dëgjojmë për çdo temë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Po mundohem të ju përgjigjem pyetjeve tu fillu nga Jakupi, e ku besoj që shumë herë e ke marr përgjigjen edhe tek kryesuesi për mungesën e tenderit për përcjelljen e seancave të kuvendit, ndërtimet pa leje, ku ke kerku një detalizim. Ju e dini që raporti paraqet në pika të trasha, e për çdo pyetje me konkrete mund të debatojmë në detale. Taulanti ka pyet për fushat sportive. Po filloj nga Ramjani, Radivojci, Pozhrrani, Smira, Sllatina, Ballanca, e kjo është kontratë dyvjeçare. Sivjet besoj që përfundon. Sa i përket pastrimit të rrugëve, mendoj që kompania ka bërë përpjekje maksimale së bashku me drejtorin me qenë prioritet, ju ka dhanë viseve malore, ndoshta dikun është vonu, po brenda ditës rrugët kanë qenë të kalueshme. Tek menaxhimi i mbeturinave nuk muj, sepse ne nuk i inkasojmë. Është kompani publike-private dhe nuk mujmë me liru prej pagesës, Liridona, sa i përket mungesës dhe zbrazësisë tek Zyra për Barazi Gjinore, te lutem pyetje me konkrete, cili informacion po të nevojitet, ndërsa sa i parket testimeve, ne kemi kalu ne vitin 2022 e jemi tu bisedu për vitin 2021. E din ti edhe këtë që testimet janë bërë tani nëpër shkolla. Në Sllatinë kërkove policët e shtrirë. Duhet me ju drejtu inspektorit të komunikacionit dhe në bazë të rregullave të komunikacionit dhe ligji, ai parashih se ku duhet të ketë. Funkcionalizimi i ambulancës në Zhiti. Me siguri vet çështja e pandemisë e ka fukusu stafin me tepër në Viti. Për ujë të pijshëm ke një ankesë, unë e di që problemi ka qenë që nuk jeni në sistem, e besoj që shpejtë do të rregullohet. Remziu më pyeti se a ka qenë ligjore çështja e bursave. Unë konsideroj që ashtu qysh e kam thanë ka qenë ligjore, sepse konkursin e shpallë DKA-ja, ne e bëjmë një komision me propozimin e DKA-së, komisioni është obligativ, t'i përmbahet kriterëve të konkursit për ndarjen e saj e jashtë saj jepet një afat ligjor dhe të gjithë ata që janë të pakënaqur kanë të drejtë të shtrojnë ankesë dhe shkalla e dyte është si organ përfundimtar, dhe pas shqyrtimit të ankesës tani kalohet procedura ligjore. Tash a ja kanë qellu normës apo jo, a ka pas ankesa apo jo, mu pak më bëjnë përshtypje ato. Po megjithatë, aspekt ligjore gjithëherë ka pas dhe ka.

**z.Jakup Demiri:** Kryetar, hyne tek puna e ligjshmërisë. Mendoj që i dimë se çka ka ndodh dhe nuk është ashtu siç thua ti, po e lamë të tejkalume. Tek memorandumit i ujitjes së tokave në Skiferaj. Na e dimë mirë që ky memorandum është nënshkruar dy ditë para zgjedhjeve dhe memorandumet e dimë që një pjesë e memorandumëve janë anuluar në Qeverinë Kurti edhe unë jam me pas ndodh ai investim tek ne, ama janë anuluar shumë memorandumet, ndërsa në investim të projekteve në Viti, asnjë qeveri më parë nuk ka mbështetur projekte

më shumë në vlerë se sa Qeveria Kurti 2, si: stadiumin në Pozharan, kyqjen e autostradës në Gerlicë, ku është nda buxheti për këtë, e ki shkollën në Pozharan që sa vite nuk është kry, tash janë nda mjetet, ndërsa kemi projekte që 10 vite që nuk janë kry. Kërkoj që muajin tjetër kryetar, që ti me qenë prezent, pasi janë pasqyrat financiare. Uroj që ky mandat të jetë transparent, të bashkëpunojmë në projekte.

**z.Sokol Haliti, kryetari i komunës:** Unë po e argumentoj, ka me u mundu me qenë edhe prezent edhe argumentues. Nuk mundesh ti me thanë se memorandum i ujitjes është be gjate zgjedhjeve, cilat zgjedhje. Ky memorandum është bë para zgjedhjeve qendrore. Mas zgjedhjeve qendrore dijet kush ka ardh në qeveri, tash vazhdim e ka qeveria, memorandum i u kanë legjitim, sepse është nënshkru në mes të kryetarit dhe ministrit, nuk ka rendësi kush ka qenë kryetar e kush ministër. Sistemi i ujitjes ka qenë dashur mu investu, sepse është investim kapital, është historik për neve, e ju duhet mu kanë me neve që me rikthy projektin, sepse është projekt kapital i pari në histori të Anamoravës, asnjë pare, asnjë cent nuk është dhënë nga kjo qeveri për Anamoravën e për Vitinë, mos e mashtroni vetveten e qytetarët. Nuk po e thamë këtë me e kritiku qeverinë aktuale, nuk e kam këtë qellim, po ju e dini që gjatë pandemisë më së shumti kam kritikë unë, e ku ka qenë LDK-ja në qeverisje me LVV-në, sepse kam kritiku parimet, në ora 12 e natës naj kane qit rezultate, deri ne ora 2 të mëngjesit kemi nejt në zyre edhe tash nuk jam tu kritiku pse është dikush tjetër në qeverisje. Edhe ti e din Jakup, që stadiumi është projekt që 3-4 vite. Në kohën e Kujtim Shalës kur ka qenë ministër është nënshkru memorandum i për dy stadiumet. Masanej ka ardh Kujtim Gashi, etj. Unë e kam memorandum me datë. Kyqja në autostradë, vendimi është bë në ish qeverinë Mustafa, në qeverinë Haradinaj ka dal tenderi, është anulë në qeverinë Kurti. Aty kanë qenë bashkëqeverisje edhe LDK-ja nuk është ajo, me rendësi kush ka qenë problemi, është tek kyqja buxheti, edhe projekti ka qenë i hartuar. Unë e kam pa këtë, i kam nejt gati. Shkolla në Pozharan e ka pas buxhetin, ka qenë projekt për të cilin dijet se qysh e kemi nxjerr, qysh është nënshkru nga Ministria e Arsimit, e kanë qu tek Administrata Publike e ku tash kjo ministri është në kuadër të punëve të brendshme, e tash zhagiten. Andej, këndej asnjë projekt të ri nuk e kemi tash nga kjo qeveri. U ngrit çështja e projekti të Mjakut. Në muajin Qershor ka qenë në bugjet projekti i Mjakut. E shef këtë edhe ti, ky projekt ka nënkuptu edhe Debuldeun, rrugën e ka pas në lloto, ka qenë i nënshkruar memorandum me rrugën alternative të Stublles, e të cilën rrugë e kanë lan që lidhet me Goden, e ndërsa projektin e Mjakut e kanë jek, tash nuk e kane shti në buxhet. Ne tash si kuvend e si qeveri, duhet bashkë me mbrojt projektin e Mjakut, sistemin e ujitjes ne Skiferaj, shkollën në Pozharan etj etj. Profesor është qudi fjalori i juaj po me befason i edukon gjeneratat e reja edhe unë i kamë informatat se ti nuk ki të drejt në shkoll mu marr me politik hiq e di edhe qka i ki dhan drejtorit qysh e ke kërcenu e di fort mirë unë.

**z.Jakup Demiri:** Ne e dimë që kemi projektet që nga 7-8 vjet pa u kry, për këtë sun kemi shti projekte te reja. Edhe një pyetje ta bëra tek memorandum i ujitjes në Skiferaj, e ke pas me 12 Shkurt të vitit të kaluar, dy dite para zgjedhjeve nacionale ka ndodh ajo, ndërsa qeveria ka qenë e rrezuar, ministri ka qenë në detyrë.

**z.Sokol Haliti, kryetari i komunës:** Për hir të informimin, nuk ka nënshkru vetëm Komuna e Vitisë memorandum, atë ditë edhe komunat e tjera kanë nënshkru. Tek shkolla e Pozharanit, tash për tash me shumë jeni ju fajtor, grupi i LVV-së, sepse qeveria qendrore e ka nën mbikëqyrje atë shkollë. Po eja ne të bëjmë presionin institucional, ta përshpejtojmë projektin e shkollës në Pozharan, stadiumin, kyqjen ne Gerlicë, etj.

**z.Jakup Demiri:** Të gjitha ato foto që i bajshe, ato takime për autostradë i ke bë vet. Memorandumet, të gjitha memorandumet e vitit 2021 janë të anuluar, është vendim i qeverisë. Sa ke mbështetje financiare në Qeverinë Kurti 2 me asnjë qeveri me herët nuk ki pas palestra në Drobeshë, Stadiumi ne Pozharan, Shkolla në Pozharan, etj.

**znj.Majlinda Shabani:** Meqenëse mu përmend emri, nga kolegu më herët, është mirë në moment që akuzon me pas argumente dhe me pas fakte. Nuk e di a me ka ndegju me vëmendje, pos kësaj, unë e kam pa

raportin për vitin 2021 edhe i kam pa ankesat dhe i kam pa mënjanimet e punëve që janë bë. Unë bëna kërkesë për drejtorin përkatëse, që bora në sheshin e Vitisë me u hek e nëse mundemi me dal e me fol me argumenti, mundemi me dal me e pa edhe trotuarin. Paraprakisht nuk jemi këtu për me e mbajt anën e kryetarit, po jemi këshilltar komunal, përfaqësojmë këshilltar edhe jemi këtu me i shpre ankesat e qytetarëve. Mu po me vjen keq që jemi në shekullin e 21 dhe flasim, akoma kemi ankesa për nevojat bazike esenciale. E shof që janë bë intervenime të shumta tek ujësjellësi dhe kanalizimi. Për çka bëhen këto! Ato bëhen për shkak se investimet janë në mënyre sipërfaqësore. Thash që investimi me qenë kapital, me qenë i qëndrueshëm dhe me qenë efikas. Në moment që ne i mënjanojmë këto problematika, atëherë mundemi me kalu në projekte të tjera.

**z.Illir Zuka:** Unë po du mu lidh me shefin e GP të LVV-së. Një muaj janë merr me Pozharan gjatë fushatës, me premtime, kanë kajt me lot të krokodillit, kanë pru ministra, kryeministra, po e bëjë shkollën, stadiumin. Një nder premtimet që u kanë, ministrja e Arsimit ka thanë në Kuvend, që në dhjetor Pozharani do ta ketë shkollën. E pas përfundimit të fushatës nuk kanë qenë asnjëherë në Pozharan. E ku po e njoftoj shefin e GP të LVV-se se, shkolla ne Pozharan vazhdon me 5 ndërrime, stadiumi është ne gjendje si ka qenë në kohën e zgjedhjeve. Ju kisha lut që bashkarish ta përfundojmë shkollën, sepse është në gjendje të mjerueshme tu mesu nxënësit, ne gjendje ne te cilën është shkolla as në shtator nuk ka mu leshu.

**z.Jakup Demiri:** Ilir, ne e dimë që aty është një problem që sa vite, e tash Qeveria Kurti është këtë vit edhe besoj që ka bë më shume se krejt të tjerat, se për juve ndoshta edhe dy mandate tjera nuk ish kry. Po më mirë është me keshyr se ku është problemi, se sa me ja gjuajt tjetrit.

**z.Illir Zuka:** Unë po besoj që ministrja i ka pas letrat në dorë kur ka than në dhjetor të 2021-ës do ta lëshojmë shkollën e Pozharanit.

**z.Jakup Demiri:** Ne kemi pas ndëgju që prej vitin 2016-2017 kanë me mesu fëmija në atë shkollë, po jemi në 2022, tash e ende nuk është leshu, e kurrë nuk e ke qel gojën deri me sot, e sot fol për këtë problematik.

**z.Durim Sylejmani:** I mbeta borxh kryetarit, i cili me tha që, në fjalimin tanë ke përdor thirrma, pasthirrma. Unë i thamë që nuk është as thirrme as pasthirrme, është gjendje para faktit, edhe këtë e di që ti nuk e kupton, po pyete një këshilltar, ai të kallëzon.

**z.Remzi Salihu:** Nga kryetari u tha që e kam kërcënu drejtorinë nëse e kam kërcënu drejtorin, ai ka qenë dashur me më paditë në gjykatë e jo tek kryetari i komunës. Po si do që të jet nuk e kam pas nijet me fol për atë, po tani po flas. Atëherë, të nderuar këshilltar, nëse doni me e gjetë degën e dytë të LDK-së në Viti, shkoni në Gjimnazin "Kuvendit i Lezhës" në Viti, aty e gjeni, hulumtoni se çka. Tek nënkryetari, i cili tha se, vendimi për bursa ka qenë i ligjshëm, por në bazë të aktgjykimi që është mbajtur në gjykatën ne Gjilan, kjo thotë që nuk është e ligjshme, sepse është dënu pikërisht kryetari i komisionit për shkaqe të tilla, edhe pyes tash kryetarin, se çka ka ndërmarr ndaj personit, sepse është konflikt i interesit, i cili është dënu, e ku ligji thotë: që kryetari i komunës, nëse ka konflikt të interesit, duhet te merr masa ndaj personit të tillë. Po e lexoj 1200 euro gjobë, pasi pranoj fajin se morri pjesë në komisionin për ndarjen e bursave ndaj djalit të tij, d.m.th Berat Zuka, shef i komisionit, edhe prapë nënkryetar vazhdo ta quajsh të ligjshëm atë konkurs. Ke pas edhe të tjerë familjar aty.

**z.Nexhat Halili:** Më herët prej këshilltarit komunal patëm polemikë për çështjen e ujit. Unë e thash, 3 muaj ditë nuk ka ujë, e ai tha 1 muaj. Nuk është me rendësi a 1 muaj apo 3, hajde po e lamë 2 muaj, unë nuk bëna pyetje për projektin e Mjakut, unë bëra pyetje për derivatet e naftës, që është inicu procedura e prokurimit, pse kur kontrata është prej Agjensionit Qendror të Prokurimit. Tek mirëmbajtja verore dhe dimërore. Unë e kuptoj që fshatrat malor kanë përparësi. Unë e di që kanë ardh pak e kanë largu boren, po jo ashtu siç kërkohet. Herëve tjera paska qenë dashur me ju thirr me shku me keshyr rrugën me pa çfarë gjendje ka qenë. Tek shenjat e komunikacionit, e keni lidh tenderin, ju përgëzoj, në Sllatinë i keni qit shenjat e



komunikacionit, mirëpo veproni edhe në fshatra tjerë, në Trestenik. Kryetari e potencoj, tatimi në pronë me përqindje prej 108.65% inkasimi edhe taksat komunale. Ju përgëzoj, mirëpo unë nuk kam këtu që ta llogaris planifikimin sa ka qenë, që ta krahasoj.

**z.Hasan Aliu nënkryetar i komunes:** Remzi e paske sos mu nguc. Për informacion po të tregoj se, këtë e din edhe ti. Për herë të parë në Viti të gjithë aplikuesit në qat rast që po e përmend ti që kanë konkuru, që kanë qenë studenta dhe që janë përputh në konkursin që e kemi shpall. Pa dallim, kryetari i komunës i ka thanë me vendim me ju nda të gjithëve bursa. Tash a ka pas naj konflikt të interesit në mesin e tyre dhe në vend me dhanë fjalë inkurajuese, që edhe këtë konkurs me shiqu a ka apet për të gjithë, e ti po pyet a ka pas rregull ligjor. Nexhat, e ka ndërpre kontratën AQP-ja, për shkak se shumën të cilën kur e kemi lidh, shuma është hargju dhe "HIB" e ka ndërpre furnizimin me derivate të naftës dhe na kanë udhëzu që me shpall tender për me vazhdu. Që është inicu dy herë kjo procedurë, për këtë nuk e di.

**z.Sokol Haliti, kryetari i komunës:** Tek çështja e ujit. Unë deshta me kalu këtë, sepse tu e dit që Nexhat e din, që projekt i kurit është uji, mirëpo tash është një problem që po e inicion për së dyti. Unë po të jap përgjigje, që jemi shumë afër, po ju një kohë thojshi që gjatë fushatës nuk ka ujë, tash po thu e keni nal ujin. E d.m.th që, ujë ka pas.

**z.Ali Bajrami:** Një sqarim ku tha parafolësi: i vetmi subjekt opozitar do të jemi pranë qytetarëve. Unë po e thamë tani si grup parlamentar i LDK-së, a jemi edhe ne votues të këtyre qytetarëve edhe a jemi edhe ne të thirrur, që do ta mbrojmë interesin qytetar të Komunës së Vitisë.

**znj.Liridona Bislimi:** Më habiti shumë deklarata e kryetarit lidhur me investimet e Qeverisë Kurti, që po bëhet tash në komunën tonë. Muu kujtu koha kur kryetari ka ardh në pushtet dhe atë kohë e di kryesuesi i tanishëm, përmendke një shkollë në Komunën e Vitisë, e cila ishte përfunduar në mandatin e PDK-së. Po kryetari vetëm që e kishte pre shirtin dhe ende në emisione keni pas polemika se, cili pushtet e ka përfunduar atë shkollë. E tash në fund tek shkolla e Pozharanit është tu investu qeverisja Kurti. Nënkryetar, tek përgjigjet që mi dhe, tek rruga e Sllatinës, me 10 Gusht 2020 kam bë kërkesë përmes e-mailit zyrtar, pikërisht atë që e keni thanë ju, përpos që e kam ngrit në kuvend, kam bë edhe kërkesë përmes emailit zyrtar tek personi që me keni pas than ju. Tek semafori, po besoj që ka qenë një temë shumë e madhe dhe shumë e rritur dhe problemi është shumë i madh, sa që tejkalohe me një përgjigje: do të bëhet. E ne e dimë çfarë gjendje është semafori tani. Edhe tek testet. Unë mendoj që është një skandal. E bëna pyetje jashtë rendit të ditës: Cili është komenti i juaj? Janë tre familje që janë ankuar për testet që po ju bëhen nxënësve nëpër shkolla, tre nxënës kanë dal pozitiv në shkollë, pastaj kur kanë shku në QKMF, kanë bë teste prapë dhe kanë rezultuar negativ. Familjet janë të revoltuar me këtë pjesë. Nuk e di, e du një koment për këtë!

**z.Sokol Haliti, kryetari i komunës:** Për teste e pysmi drejtoreshën e QKMF-së, e të informojmë për këtë. Semafori. Ne mujmë me marr vendim i dhezmi. Atë që është prish në aksident e rregullojmë, e nuk është naj far problemi. Shiritat mund t'i presim krejt bashkë, vetëm ta rregullojmë shkollën, mirëpo unë po kërkoj nga qeveria, që të këtë investime në komunën tonë dhe të përkrahen projektet tona.

**z. Bekim Azizi, kryesuesi i kuvendit:** Ne jemi të obliguar të punojmë së bashku në interes të qytetarëve.

**z.Jakup Demiri:** Unë e kam një pyetje për drejtoreshën e arsimit. Të naj jep një bilanc për gjendje momentale, se qysh e kemi gjendje në arsim.

**znj.Fatbardha Emimi, drejtoreshë e arsimit:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pasi që është fjala e parë në këtë mandat, kërkoj bashkëpunimin nga të gjithë, sepse jemi në interes të qytetarëve. Ne si Drejtori e Arsimit, jemi përballur me probleme të virusit, sepse ka qenë prezent shumë këto ditë, që sidomos në javën e kalume pa përjashtu edhe shkollat, po duhet rrespektu gjithmonë rekomandimet e Institutit të Shëndetësisë në koordinim të plotë me taksforcën komunale, që e udhëheq kryetari i komunës. Jemi dakordu bazë udhëzimit

të Ministrisë së Arsimit dhe jemi mundu në përpikëri ta respektojmë këtë udhëzues për zhvillimin e procesit arsimor në kushtet e pandemisë. Fillimisht me takimet e rregullta me drejtorët e taksforcën komunale, në koordinim të plotë me Qendrën e Mjekësisë Familjare në Viti, kemi kërku që të bëhet testimi rapid nëpër shkolla, në ato shkolla ku frekuentimi është me i madh i nxënësve, dhe në ato shkolla ku kërkesa e bartësve të institucioneve ka ardh si shenj që ka paralajmërime se, ka një numër të madh të nxenesve që mungojnë në procesin arsimor dhe në këto testime deri nga data 13 janar kanë kalu numri mbi 2000 testime rapide në institucione arsimore, edhe këto testime janë bë nga stafi i QKMF-së, tu kërku një bashkëpunim në aspektin teknik të regjistrimit, i kanë ndihmu stafi i shkollës, për shkak se është një numër i madh i pacienteve që kërkojnë shërbime edhe në QKMF, e nga data 13 e deri me sot që janë testu pozitiv nxënës kemi 298 nxënës dhe dikun 60 mësimdhënës. Po flas për të cilët nga sot jeken nga kjo listë për shkak se i kemi pas 6 shkolla onlajnë, nga sot kanë fillu mësimi me prezencë, dhe nga sot kanë shku dy shkolla tjera, shkolla e Beguncës dhe e Terpezës, kjo krejt prej mundësisë me parandalu përhapjen. E kemi pa që, në javën e kalume janë dezinfektu të gjitha shkollat. Masat mbrojtës: në të gjitha shkollat ka pastrues e mjete higjienike. Unë këtu nuk muj pa i falënderu edhe mësimdhënësit, pavarësisht që kanë qenë pozitiv. Po fal Zotit, të gjithë janë mirë me shëndet dhe nuk kemi rast të hospitalizimit, as të mësimdhënësve, as të nxënësve, e gjatë kësaj jave e kemi situatën më të menagjueshme. Unë kërkoj bashkëpunim nga të gjithë!

**z.Bekim Azizi, kryesuesi i kuvendit:** Ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë për këtë pikë. Tani vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Si pike të katërt kemi:

#### **4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2022**

Propozim vendimin me material e keni marrë me kohë. Unë hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Jakup Demiri:** Unë mendoj që, tek seancat solemne duhet mu parapa edhe “28 Nëntori”, të jete seancë solemne, me rastin e Pavarësisë së shteti shqiptar.

**z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit:** Ne këtë festë çdo vit e festoj me seancë solemne, mirëpo kjo datë caktohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e në këtë që I kemi cek, I kemi me statut të komunës. Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të pestë kemi:

#### **5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)**

**z.Hasan Aliu, nënkryetar:** E keni në preambulë udhëzimin bazë, me të cilin udhëzim edhe formohet KKSB-ja. Të gjitha këta emra që janë këtu janë bazuar në këtë udhëzim dhe ne i kemi obligim t'i plotësojmë në bazë pozitive të tyre.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

#### **6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacioni për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti**

**z.Hasan Aliu, nënkryetar:** Në mungese të drejtoreshës, e cila është me Covid 19, po e bëjë prezantimin e kësaj pike. Gjykata ka bë një kërkesë për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e objekti të

gjykatës. Ne kemi vendos, që pas hulumtimit kemi gjete, që kjo pronë është e Komunës së Vitisë dhe me të ndarjen e me ju leju ndërtimin e objektit që I plotëson kushtet për ta.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Jakup Demiri:** Tek kjo parcela momentalisht i kemi zjarrfikësit, e nuk e di a kemi të ndonjë zgjidhje për ta. E kam edhe një shqetësim tek pika tjetër, për çerdhen. E tash çerdhja edhe gjykata e kanë një natyrë të ndryshme të funksionimit. A kishmi mujtë me të një ndryshim ose për gjykatën ose për çerdhen, se po me duket të njëjtin vend çerdhja me fëmijë edhe puna e gjykatës. E dimë që puna e gjykatës me polici është e natyrës tjetër.

**z.Sokol Haliti, kryetar i komunës:** Ka qenë kërkesa e Këshillit Gjyqësor, të cilët e kanë siguruar fondin për ndërtimin e gjykatës, e ne kemi dashtë t'i kthemi përgjigje pozitive. Duhet të mendojmë edhe për stacionin policor, po nuk kemi zgjedhje shumë tjera rreth pronave. Çerdhja do të jetë në pjesën tjetër që do ta ketë rrugën paralel, sepse e kemi shqyrtu dhe e kemi pa me hartë katastrale, çerdhja e ka rrugën alternative.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Tek zjarrfikësit objekti është i nderuar, duhet me ngut pak, që ata me dal tek objekti i tyre i cili është ndërtu.

**z.Taulant Haxhiu:** Kryetar, çka do të bëhet më vonë me objektin ekzistues të gjykatës që është sot? A keni ndonjë plan? Sepse ai objekt mbetet i zbarët.

**z.Sokol Haliti, kryetar i komunës:** Pronësia e këtij objekti është pronësi e policisë, po ne po mendojmë që as vendi i policisë nuk është aty, po mendojmë me të një dislokim atje. E kam një ide, po do ta diskutojmë me kohë.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Nën kryetar, ky propozim vendim a ka me u plotësu me një nen.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar:** Për shkak se vendi ku janë zjarrfikësit në një vit dikun 2005, Kuvendi ka vendos që atë pjesë me ja dhanë Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe pasi që disa vite nuk ka aty trupa mbrojtëse, ne e kemi vendos zjarrfikësit dhe me këtë propozim vendim, me një nen do ta shfuqizojmë atë vendim për me ju leju gjykatës.

**z.Sokol Haliti, kryetar i komunës:** Kuvendi komunal ka të drejtë me marr vendim për pronën e vet komunale.

**z.Nexhat Halili:** Një pyetje. Ne tani kemi me marr vendim me e shfuqizu një vendim. Tash nëse e votojmë në këtë vendim në mbledhjen tjetër po votojmë për shfuqizim. A kanë kjo pikë të shtyhet për mbledhjen tjetër, sepse nëse kemi me shfuqizu një vendim, njëherë e shfuqizojmë atë, tani e miratojmë këtë vendim.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar:** Ne me këtë vendim e shtim një nen, me të cilin thajmë që shfuqizohet vendimi I mëparshëm.

**z.Sokol Haliti, kryetar i komunës:** Ne mujmë me shty, po e hupim afatin e dorëzimit të dokumentacionit për çerdhe, e hupim donacionin. Për këtë po dojmë me dergu me kohë.

**z.Remzi Salihu:** Ne si kuvend shumë here po ngutmi me i miratu vendimet. Shumë mirë e tha shefi i grupit, Jakupi, se mundet të na kthehet i kundërligjshëm, për shkak afërsisë së objekteve, sepse e dimë karakteret e gjykatës edhe çerdhes, e ku në gjykatë në disa raste sillen kriminelët, e ku mund të ketë situata të palakueshme. Unë jam i mendimit, që ta peshojmë më mirë këtë punë. Kryetari u thirr në atë që po na hupin donacionet, e duhet të miratojmë. Ne pikërisht në legjislaturën e kalume e kemi miratu një me procedurë të shpejtë për ndarjen e një parcele atje tek shtëpia e shëndetit, për persona me të meta mendore edhe sot e atë ditë unë nuk kam pa se çka është bë me atë iniciativë që e kemi votu ne. Unë po lidhem me Negjatin, sepse në fillim duhet te shfuqizohet një vendim e tani të miratohet tjetri.



**Ilir Zuka:** Unë po mendoj se çdo vendim shfuqizohet me një vendit të ri dhe çdo rregullore me rregullore të re. Këtu në propozim vendim nuk është e cektë, e në rast se e cekum që duhet mu shfuqizu është në rregull.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Në koordinim edhe gjykatën komunale është një dakordim edhe me lokacionin. Unë e kisha qit në votim që, a jeni të kaloj ky propozim për caktimin e lokacionit, duke e plotësu me një nen brenda këtij propozimi anulimin e vendimit 226-2002, në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal të Vitisë Nr. 02-013/5594, të datës 31.12.2008. A jeni që të miratohet ky propozim vendim me këtë ndryshim. Nga të gjithë u miratu ky propozim vendim.

Si pikë të shtat të rendit të ditës e kemi:

**7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e çerdhes së fëmijëve në Viti**

E njëjta procedurë. Hapim debat për këtë pikë. Pasi që nuk ka për diskutim, qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të tetë të rendit të ditës e kemi:

**8. a) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin e Vendimit 01-110/05-976, të datës 28.12.2021, për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;**

**b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin e Vendimit 01-110/05-974, të datës 28.12.2021, për formimin e Komitetit për Komunitete.**

a) Ne seancën e kalume e kemi miratu vendimi për themelimin e komiteteve, tani i kemi marr edhe emrat si në Komitet për Politikë dhe Financa janë këta: Nga LDK-ja, Ramadan Deliu, Ilir Zuka. Zejnene Osmani; nga LVV-ja, Jakup Demiri e Liridona Bislimi; nga PDK-ja, Zyrafete Rama dhe kryesuesi shkon direkt. Janë këto propozime që kanë ardh. A jeni pro këtij propozim vendimi? Miratohet nga të gjithë kjo pikë e rendit të ditës.

b) Në Komitetit për Komunitete kemi këto propozime: Reshat Azizi nga AAK-ja dhe Vilsona Maliq-Salihu nga PDK-ja. Ndërsa propozimet tjera i keni: Radovan Djuric, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, përfaqësuese nga komunitetit serb: Kata Pala, anëtar përfaqësuese nga komuniteti kroat; Ibrahim Berisha, anëtar përfaqësues nga komunitetit hashkali. A jeni pro këtij propozim vendimi? Me tri vota apstenim, tjerat pro, miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:20 min.

**Procesmbajtësi:**

**Fatlum Demiri**

---

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**

**Bekim Azizi**

